



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
DREJTORIA E NDIHMËS JURIDIKE FALAS

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2025

**NJOFTIM MBI KANDIDATËT QË PLOTËSOJNË KRITERET PARAPRAKE PËR THIRRJEN:
« PUNONJËS ME TRAJNIM TË POSAÇËM PRANË QENDRËS SË SHËRBIMIT TË NDIHMËS
JURIDIKE PARËSORE LUSHNJE »**

Komisioni për zhvillimin e procesit të konkurimit për vende të lira pune në Qendrën e Shërbimit të Ndihmës Juridike Parësore Lushnje ngritur me urdhër nr. 759 datë 15.12.2025. të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas, u mbledh më datë 22.12.2025, me qëllim shqyrtimin e aplikimeve, sa i përket përmbushjes së kërkesave të posaçme dhe dokumentacionit sipas thirrjes së publikuar në faqen zyrtare të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas¹ si dhe në bazë të nr. Urdhrit nr. 53 datë 26.05.2021, të Drejtorit të Përgjithshëm të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas «*Për miratimin e metodologjisë së vlerësimit të kandidatëve për punonjës pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore*».

Rezulton se se për këtë vend vakant kanë shprehur interes **5 (pesë) aplikantët** në rend alfabetik si vijon:

1. **Zj. Aida Koçi;**
2. **Zj. Eva Sanxhaku;**
3. **Zj. Flavia Qirushi;**
4. **Zj. Roksana Sulko;**
5. **Zj. Xhulja Sula.**

Pas shqyrtimit të dosjes personale të dorëzuar nga çdo aplikant, rezulton se referuar vendimit të Komisionit të vlerësimit **aplikantët të cilët plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e janë:**

1. **Zj. Eva Sanxhaku**

Pas shqyrtimit të dosjes personale të dorëzuar nga çdo aplikant, rezulton se referuar vendimit të vlerësimit të Komisionit **aplikantët të cilët nuk plotësojnë kriteret për të vazhduar procesin e konkurimit (sipas rendit alfabetik) janë:**

1. **Zj. Aida Koçi** (mungon dokumentacioni provues I cili vërteton plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme sipas thirrjes);

¹ <https://ndihmajuridike.gov.al/index.php/vende-vakante/>

2. **Zj. Flavia Qirushi** (mungon dokumentacioni provues I cili vërteton plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posacme sipas thirrjes);
3. **Zj. Roksana Sulko** (mungon dokumentacioni provues I cili vërteton plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posacme sipas thirrjes);
4. **Zj. Xhulja Sula** (mungon dokumentacioni provues I cili vërteton plotësimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posacme sipas thirrjes).

❖ **Provimi me shkrim** do të zhvillohet më datë **30.12.2025, ora 11 :00**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Provimi me shkrim do të konsistojë në njohuritë mbi ligjin nr. 111/2017, «Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti » si dhe në pyetje mbi formimin e përgjithshëm të aplikantit në fushën e të drejtës Civile; Penale; Administrative dhe Tregtare.

❖ **Intervista me gojë** dhe do të zhvillohet më datë **30.12.2025, ora 12:00**, pranë ambienteve të Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas.

Aplikantët gjatë intervistës me gojë do të vlerësohen në lidhje me: Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës; Eksperiencën e tyre të mëparshme; Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

(në mungesë)

**DREJTORI I DREJTORISË SË ZBATIMIT TË POLITIKAVE DHE
ADMINISTRIMIT TË NDIHMËS PARËSORE
Patricia Pogaçe**